

VEÇORITË MORFOLOGJIKE DHE PËRDORIMET E PASKAJORES NË VEPRËN "CUNEUS PROPHAETARUM" TË PJETËR BOGDANIT

Eliana PAÇO

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Tiranë

Punim studimor

Ndryshe nga shumë gjuhë indoevropiane, shqipja nuk ka një paskajore sintetike, të formuar nga ndonjë prapashtesë të veçantë. Paskajorja e gjuhës së sotme shqipe është një ndërtim më i ri. Në planin e gjuhës së sotme ajo interpretohet si një pjesore e paraprirë nga pjesëza me origjinë parafjalore *me*. Ky ndërtim analitik, që njihet dhe përdoret vetëm në dialektin e veriut, i përgjigjet paskajores së mirëfilltë me të gjitha funksionet e saj kryesore.

Për sa i përket ndërtimit *për+emër foljor i gjinisë asnjane* në trajtë të pashquar, që zakonisht mbahet si një paskajore e dytë, duhet thënë se ai vetëm në pak funksione i afrohet paskajores, pra, është një ndërtim që ka marrë rrugën e shndërrimit në një paskajore.

Për ekzistencën e një forme të vjetër të një paskajoreje sintetike nuk mund të thuhet asgjë me siguri. Disa gjuhëtarë si A. Xanoni, Kr. Sandfeldi, A. Xhuvani, S. Riza, etj., duke parë analogjinë në përdorimin e pjesores së shqipes pas foljeve modale *do*, *duhet* me gjuhë të tjera indoevropiane, supozojnë ekzistencën e një paskajoreje joperifrastike, të

paraprirë nga pjesëzat *me, për*. Por, së paku për shqipen e sotme, elementi i dytë në ndërtimin *duhet bërë* nuk mund të interpretohet si paskajore, sepse siç është provuar nga Sh. Demiraj¹ dhe M. Gabinski², ai ka kuptim pësor, kur vjen prej një foljeje kalimtare (*duhet bërë* kjo punë e jo *duhet bërë* këtë punë).

Forma perifrastike e paskajores është relativisht e re. Ajo duhet të jetë krijuar, sipas A. Xhuvanit, nga ndërtimet me parafjalën *me* në fjali të varura. Parafjala *me* ka shërbyer për të shprehur lidhjen midis paskajores dhe fjalës drejtuese. Disa gjuhëtarë të tjerë si Dozoni, Pedersen, Pavloviqi e më fort Kr. Sandfeld janë të mendimit se shqipja krahas paskajores përdor me vlerën e saj dhe format e lidhores.

Lidhorja përdoret me vlerën e paskajores në disa gjuhë të Ballkanit, sidomos në greqishte nga e cila Kr. Sandfeldi mendon se është ndikuar edhe shqipja. Sh. Demiraj e S. Mansaku dhe gjuhëtarë të tjerë shqiptarë e kanë hedhur poshtë këtë mendim si të pambështetur. Lidhorja është përdorur me vlerën e paskajores edhe në veprat e autorëve të vjetër shqiptarë të veriut, gjuha e të cilëve ka qenë më larg ndikimit grek.

Si formë foljore e pashtjelluar, paskajorja shpreh një veprim pa iu referuar një vete të caktuar. Asaj i mungon edhe kategoria gramatikore e kohës, sepse nuk ka aftësi ta vendosë veprimin në një pikë të caktuar të referimit kohor. Procesi i shprehur nga paskajorja mund t'i referohet së tashmes, së shkuarës ose së ardhmes.

Paskajorja nuk ka as modalitet të pavarur, në kontekste të caktuara mund të fitojë kuptime modale të mënyrave të tjera.

Ndryshe nga latinishtja dhe greqishtja e vjetër, paskajorja e të cilave karakterizohet nga një sistem i tërë formash për kohë e diateza të ndryshme, paskajorja e shqipes ka një formë të vetme që ndryshon vetëm sipas diatezës.

Materiali i vjelë nga vepra e Bogdanit nxjerr në shesh përdorimet e larmishme të paskajores të ky autor. Ndërtimet me lidhoren nga pikëpamja e dendurisë janë më të rralla.

Këtu duhet pasur parasysh ndikimi i gjuhës së folur në dialektin përkatës, por nuk përjashtohet edhe ndikimi i konstrukteve të tekstit italisht. Gjatë shtjellimit të lëndës do të përpiqemi që këto ndikime t'i vëmë në dukje.

¹ Sh. Demiraj, *De la disparation de l'infinif en albanais*. Etudes Balkaniques, 1970, f. 18.

² A. M. Gabinskij *Pojavlenie i utrata pervicnogo albanskogo infinitiva*. "Nauka" Leningrad, 1970, f. 336.

Veçoritë morfologjike

Në veprën e Pjetër Bogdanit, krahas me formën perifrastike *me+pjesore* del edhe ndërtimi i tipit *për të +pjesore*.

Një përdorim kaq i gjerë i paskajores shpjegohet në radhë të parë me përmbajtjen e tekstit dhe, së dyti, këtu duhet pasur parasysh edhe ndikimi i gjuhës së folur, d. m. th. i dialektit të gegërishtes veriore, ku paskajorja përdoret dendur. Ndryshe nga toskërishtja, në këtë dialekt zëvendësimi i paskajores nga lidhorja është një dukuri më e kufizuar.

Në krahasim me paskajoren me pjesëzën *me* ndërtimet *për të* dalin shumë më rrallë. Raporti është përkatësisht 2613 herë me 611 herë. Ka rëndësi të vihet në dukje se te Bogdani paskajorja me pjesëzat *për me* nuk del në asnjë rast.

Paskajorja me pjesëzat *për të* del si një paskajore e dytë. Kjo mund të jetë si një formë me anë të së cilës dalin më qartë disa funksione qëllimore. Pra që në kohën e P. Bogdanit njiheshin të dyja format e paskajores. Akoma edhe sot në disa të folme të gegërishtes veriore përdoren të dyja format e paskajores, ajo me *me* dhe ajo me pjesëzat *për të* ose *për me*³.

Te Bogdani haset edhe një formë e shkuar e paskajores e formuar nga e ashtuquajtura paskajore e tashme, e foljeve *kam* dhe *jam* dhe nga pjesorja e foljes themelore.

Disa autorë gramatikash si M. Xanoni, K. Cipo, O. Myderizi, A. Xhuvani etj. këtë formë e kanë trajtuar si kohë të shkuar të paskajores.

Më të shumtën e rasteve paskajorja përdoret me formën e saj të thjeshtë e me një kuptim kohor të kushtëzuar nga koha e foljes prej së cilës varet. P.sh.: Trembëdhjetë vjeç zu fill *me profetizuem*, e kje derguem prej Sinëzot... C. P. I, VII, 1; Tue pasunë Eva kërkuem pemenë, e dha ende *me kerkuem* Adamit... C. P. I, VII, 1; pasi e pa shportenë, e bani *me ja sjellë* ... C. P. I, I, 1; u lut *me kjanë gjegjunë* e të hinte ke rregi... C. P. I. IX, 3; do zotynë Hyj *me kjanë nderunë*... J. Ch. II, VI, 18; kjenë bam të denjë *me kjanë thirrë* bijtë e Tinezot... C. P. I, VII, 13.

Në veprën e Bogdanit ndërtimet prej paskajores dhe formave vetore të së tashmes ose të të pakryerës të foljeve *kam* e *jam* përdoren si forma analitike të së ardhmes së dëftores, përkatësisht të së tashmes së kushtores.

Në vepër dalin 840 raste të së ardhmes perifrastike të këtij tipi me pjesë të dytë paskajoren me *me* dhe 140 raste me paskajoren me *për të*.

³ Sh. Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vile Kalisit të Lumës* – D. Shq. III 1975, f. 138.

Këtu kemi të bëjmë me një veçori të gegërishtes veriore, prandaj edhe në veprën e Bogdanit e ardhmja me *do të del vetëm në një rast*, p.sh.: ende *ky ka me kjanunë* kush... C. P. I, II, 26; *kam me të mpsuem* qish flaç... C. P. I, I, 10; *kanë me u lekundunë* idhuijt e Misirit... C. P. II, VI, 20; *se ke për të ecunë* për tri ditë... C. P. I, I, 8.

Kohët perifrastike të ndërtuara nga e pakryera ose e kryera e thjeshtë e foljes ndihmëse *kam* dalin 273 herë. P.sh.: ende pa menguem kuraj *kish me lem* shembelltyra... C. P. I, II, 9; perse me kjanë nde tre vetë nukë *kish* tri heresh Mojsezi *me promendunë* emenitë Tinezot... C. P. I, III, 9; i ra nde mend se zotynë *kish për të veperuem* kafshët e mëdha... J. Ch. II, III, 11; përse thuejnë qi s'ka kurraj te nderruem, *kishin me bam* te nderruem e te dvekunë... C. P. I, II, 8; *kish me kjanë* pa ndonji te dhimptunë, e të lekundunitë gjymtyrevet *pat me kjanë* ndenë urdhenite e volendetese... C. P. I, VI, 19; kur kje krijuem nuk *pat me dekunë*... C. P. I, VI, 8.

Midis foljes ndihmëse *kam* dhe paskajores mund të futen fjalë të tjera me funksione të ndryshme në fjali. Kjo tregon se këto forma perifrastike me vlerën e së ardhmes nuk janë plotësisht të gramatikalizuara. P.sh.: nukë *kish* tri heresh... *me pomendunë* emenitë tinëzot ani për te thanë anshte nja... C. P. I, III, 9; e mbe te sillt *kam* ma fort *me kujtuem e me vum roe?*... C. P. II, II, 1; këta arresye *kanë* këtu *me u kallëzuem* disa ma te mëdhate. C. P. II, II, 3.

Me të ardhmen e foljeve ndihmëse *kam* e *jam* dhe me pjesoren e foljes themelore forcohej një trajtë perifrastike që ka kuptimin e së ardhmes së përparme. P.sh.: ndjerë kohët se pa njoftune e...*ka me kjanë dukunë* gjithë shekullit ngushellimi Tinezot... C. P. III, VI, 15; ende mbe qiellt, prej Jezu Krishtit *ka me kjanë druem* Darket se Qellet... J. Ch. II, V, 15; E lum ata qi kjanjene... per se mirëfilli *kanë me kjanë ngushelluem*... J. Ch. II, III, 2.

Edhe në këto forma kemi mjaft raste ku pjesët përbërëse ndahen nga gjymtyrë të tjera që hyjnë në mes. P.sh.: *kanë me kjanë* prej Sinezot *grykuem*... J. Ant. IV, IV, 21; *ka me kjan* dheu *qeruem*... J. Ant. IV, IV, 20.

Format joveprore të së ardhmes formohen nga format përgjegjëse veprare me pjesëzën *u*. P.sh.: Posi Lili *ka me u ngushellue* për t'u gëzue, e për të levduem... J. Ch. I, IV, 1; perse *ka me u dvjerrë* urtija... e endja e dijteshimet tinaj *ka me u mpshefunë*. C. P. II, IV, 13; vrae barinë e *kanë me u perderdhunë* deletë... C. P. III, II, 9.

Në këtë rast është paskajorja që i jep kuptim pësor gjithë togut. Edhe format perifrastike të së ashtuquajturës mënyrë kushtore trajtën joveprore e formojnë me pjesëzën *u*. P.sh.: nukë *kish me u pam* prej syshit sinesh... C. P. I, IV, 36; me prekune skanje... keshe *me u shendo-shunë*... J. Ch. II, II, 19; kur profetizoj ende me tribu...*kishinë për t'u bam* bashke per te vram shembuesinë... C. P. I, VII, 19; Me pam ndë një pasqyrë një dritë pakezë larg, *kishinë me u dukunë* tri drita... C. P. I, II, 19.

Në përdorimin e saj paskajorja del në formën pohuese dhe mohuese. Forma mohuese formohet me pjesëzën *mos*. P.sh.: e ban Evenë, *me mos lanë* Adaminë... C. P. I, VI, 21; i sillti *per te mos i dhanuem* gruenë... C. P. I, VII, 1.

Pjesëza *mos* pothuaj kurdoherë vihet në mes të pjesores dhe të fjalëve *me ose për të*. Paskajorja te Bogdani paraqitet në diatezën veprore e joveprore. Diateza joveprore dallohet nga ajo veprore nga pjesëza *u*. P.sh.: perse Mojsezi permetoj *me u leshuem* gratë I, I, 9; nukë guxojnë *me u lekundunë* asi vendi I, I, 21; tue fluturuem dy kut nalt dheut, lireshinë *me u zanë* prej Izraelitësh... C. P. I, I, 26.

Paskajorja joveprore del dhe në formën mohuese me pjesëzën *mos*. P.sh.: thanë se kanë një zot i cili i ka gjithë krijuem e ruejtunë... dheu *me mos u ntretunë* C. P. I, I, 6.

Pjesëza *mos* hyn në mes të pjesëzave *me ose për të* dhe të pjesores së foljes. P.sh.: e ban Evene, *me mos lanë* Adamnë... C. P. I, VI, 21; e se thoj *me mos u paguem* Theosi C. P. II, II, 2; Dshnë *me mos ja menguem* ende Jezu Krishne C. P. II, III, 3; Ka ndonjë rast ku pjesëza *mos* del para pjesëzës *me*, p.sh.: tue pam një keshtu te madhe pune... jo me u lodhuni së dhimptuni ndo ndë *mos me kjanë*... C. P. II, III, 10.

Përdorimet e paskajores

Paskajorja, siç dihet, njeh dy përdorime kryesore: një në fjalitë e varura, që mund të quhet ndryshe përdorimi i varur i paskajores dhe një përdorim tjetër në fjali të pavarura. Në veprën e Bogdanit paskajorja e pavarur del rrallë, kryesisht me kuptimin e detyrimit. Ajo shpreh urdhër, nxitje ose këshillë ose lutje. Së pari dallojmë paskajoren e pavarur me kuptimin e mënyrës urdhërore. P.sh.: Përse me mos kjanë ashtu, Abrami nukë kish me pasë thanë aty tre veteve: O zot, e per një te vetemi Hyj, *me i adhëruem*, (signore, e come un solo Dio quello adorato) C. P. I, III, 3; Pra, *me besuem* (credendum est) se ky Hyj ansht te keqiat e femijenisë

duron... J. Ch. I, IV, 2; e nde u dukete gja kafshë feshtirë, prej si me të përvutë *me te pevetunë*, jo posi te shenjtënitë me bujtunë, si mundete ky neve me na e danë mishtë vet per te ngranë? J. Ch. II, IV, 14.

Urdhri i shprehur nga paskajorja në këto raste ka një karakter më të zbutur. Kjo shpjegohet me këtë se paskajorja nuk mund të shprehë një urdhër me ton të prerë. Paskajorja e pavarur del në ndonjë rast dhe me kuptim nxitës. P.sh.: Oh te padijtunë, te plogë nde zemera tuej, *me besuem* kafshe qi thanë profetetë... J. Ch. IV, I, 12; Te feshtirete o protesa *me bam* mirë (la dofficolt á di bene operase)... C. P. I, VII, 5.

Në shembujt e mësipërm thirrëri shërben si kryefjalë e pavarur. Paskajorja e pavarur del edhe në fjali pyetëse. Kemi këtu një përdorim të rrallë edhe tek autorët e tjerë të vjetër. P.sh.: Perse deshe keshtu me dekune e mue *me më lanë*? J. Ch. III, III, 11; Si pra *mujte me më lanë* kështu? J. Ch. II, III, 12.

Ja edhe disa shembuj me paskajore të pavarur me kuptimin e një lutjeje. P.sh.: e tash *me pam* kush kish me kjanë ai qi te mos kjanë... C. P. I, II, 3; Nje ma i madh se Solomoni Hyj, *me na kallëzuem* se anshte i verteti Solomon, e i verteti Gjona... C. P. II, I, 25.

Përdorimi i pavarur i paskajores mund të jetë edhe një pasojë e elipsit të foljes *duhet* (lypset), e cila shpreh domosdoshmëri⁴.

Paskajorja në veprën e Bogdanit përdoret edhe pas foljes modale *mund* e cila mund të dalë në kohë, vetë, numër e mënyra të ndryshme. Me temën *mund* kjo folje del në kohën e tashme e të pakryer të dëftores, në të tashmen e habitores, në të pakryerën e lidhores, si dhe në paskajore e përcjellore.

Ndërsa në të kryerën e thjeshtë të dëftores dhe në të pakryerën e habitores del me temën *mujt* (*mujti*, *mujteke*). P.sh.: Se Hyj *mujti* më shumë mendyrë *me kerkuem* te gjegjunitë... C. P. II, II, 18; (e kryer e thjeshtë). Pa e soditeni a *mundeni me njoftunë*, perse unë qi e leva mzi se po e njof... J. Ch. III, IV, 1; Si *mundeni me i ram* mboh, se Hyji, krijues jo veçe se i natyrese... C. P. I, II, 9 (kohë e tashme e dëftores) aqa sa nukë *mundje*, *me u nginjunë* tue soditunë... J. Ch. III, I, 12; u dukunë gjymtyretë e eshtenavet aqa sa *mundeshinë me u njehunë*... C. P. III, III, 3; *te mundinjë me prekunë* skanjë sundimit te shembuesit... J. Ch. II, II, 19; (e pakryer e dëftores dhe e lidhores).

⁴ S. Mansaku. *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj*. S. F. 1982/1, f. 140.

Në këto raste kuptimi kohor i paskajores varet nga ai i foljes *mund*, d.m.th. shpreh një veprim të njëkohshëm me të. Folja *mund* jep kuptimin kohor e vetor, ndërsa diatezën e shpreh vetë paskajorja. P.sh. as gja mangu nukë *mujtinë* Tinëzot *me i kjanë* per aqa gazamend e shije... C. P. I, II, 3; nde *mundete* kurraj nde dite tona për të gjallë *me u thirrune* shenjt. C. P. I, XI, 10; *te mundeshinë* pa manese *me u thirre*... J. Ch. I, II, 5.

Shembujt e sjellë pak më sipër tregojnë se brenda togut *mund* + *paskajore* hyjnë edhe gjymtyrë të tjera të fjalisë, gjë që tregon për një pavarësi të togut. Këto togje mund të shprehin një mundësi ose pamundësi të realizimit të veprimit. Kur folja ndihmëse *mund* është në trajtën mohore, kemi pamundësi të kryerjes së veprimit. P.sh.: aq sa nukë *mundeke me nderruem* kombete... J. Ch. III, IV, 6; as gja mangut *nukë mujtinë* Tinëzot *me i kjanë* per aqa gasamend' e shije, C. P. I, II, 3. Kur folja *mund* është në të tashmen e në të pakryerën e lidhore i gjithë togu merr kuptimin e një të ardhmeje. P.sh.: Ma fënikeshë, e delirë që *të mundej* kurraj *me u gjetunë* nder gjithë kreatyret... J. Ch. I, I, 3. Gjith kush *tëmundej me njoftunë* se vetë zotyne ish aj... J. Ch. I, IX, 10; Po ku *të mos mundeni* na me mbërrim fjala e Hyjit qellet... te na forcojë. C. P. I, I, 25.

Kur folja *mund* qëndron në të ardhmen ose në të ardhmen e së shkuarës (përndryshe kushtore), gjithë togu shpreh një veprim të mundshëm, që pritët të kryhet pas një çasti të caktuar të së tashmes ose të së shkuarës. P.sh.: *kanë me mujtunë me votë* mbe gjithë anet... J. Ant. II, IV, 26; *kishinë me mujtunë* mbe Qiellt me pasunë vise të ndershime... J. Ch. II, VI, 6.

Në veprën e Bogdanit takojmë dhe ndërtime me foljen modale *mund* në përcjellore, të ndjekura nga paskajorja. P.sh.: nukë kanë me ndiem ndonji mund, veçë kanë me pasunë një të madh ngushëllim, *tue mos munjtune me pam* Hyjnë krijuesin e vet... J. Ant. IV, IV, 32; *tue mos munjtune me duruem* ma duel jashtë... J. Ch. II, I, 17; Perse *tue munjtune me lypunë* jetenë gjatë, begati... Nukë lypë as ndonji keso punesh... C. P. III, IV, 2.

Kryefjala e këtyre foljeve është e njëjtë. Te Bogdani nuk mungojnë edhe rastet kur folja *mund* mund të jetë në paskajore. Te Buzuku ka vetëm një rast të tillë. Paskajorja e foljes *mund* herë-herë është e barbartë kuptimisht me një lidhore. P.sh.: Oh *me mujtunë me pam* si e rrethuenë mbe gjith' anet... J. Ch. III, IV, 9; (oh se si potese vedere).

Paskajorja te Bogdani formon një unitet sintagmatik gramatikor me foljet modale *mund* e *duhetë*, të cilat e humbin vlerën e tyre leksikore dhe

hyjnë në serinë e foljeve gjysmëndihmëse. Në këtë rast janë foljet modale ato që karakterizojnë (drejtojnë) veprimin e paskajores. Pra, këto folje luajnë rolin kryesor gramatikor, duke treguar mënyrën, vetën e kohën, ndërsa paskajorja mbart vetëm kuptimin vepror e jovepror (diatezën). P.sh.: prashtu bukur e kendyek dukete se' nieri nukë *duhetë me u uzdatunë* mbe dijet. C. P. III, IV, 13; Aty *duhete me vum roe* se Hyji tue kjane nja ndë Natyrë... C. I, III, 1; Andaj marrene vesht se nde gjithë punet e Krishtit, nukë *duhete me u dalë* përsiperi... C. P. I, III, 7; nukë *duhete me i marrë vesht* si kumbon fjala C. P. I, III, 4; asgja mangu nder ne nukë duhete, as nukë *mundete më u pam* C. P. I, IV, 51; te dhimptunite e qi ajo pak nukë *mundete me u kallezuem*... C. P. II, II, 20; me nji baftu, nji miqe shekulla *mundet me krijuem* C. P. II, IV, 12.

Te Bogdani krahas këtyre ndërtimeve dalin dhe ndërtime të ngjashme me këto, me foljet modale *duhet, do* me një pjesore që për nga vlera kuptimore janë të njëjta me ndërtimet e mësipërme d.m.th. ndërtimet folje *modale me një paskajore*. Në këto ndërtime, sipas disa studiuësve, ruhet një paskajore e vjetër joperifrastike. Ndërtime të tilla, në veprën e Bogdanit zënë një vend të konsiderueshëm. P.sh.: ata nukë *duhete marre vesht* per rregjenit e kesaj jete... C. P. I, III, 15; Salmatë *duhene marre vesht* per letere C. P. I, III, 1; tha se ajo kishe qi kallezon, Eksekiel nukë *do marrë vesht* per nji kishe landeje... C. P. I, II, 4; se feja *do shogenuem* me vepera të mira... C. P. II, I, 21; *do djegune* zjarm te dashunite time C. P. I, II, 14.

E ngjashme me foljet modale *do, duhet, mund* në veprën e Bogdanit del në disa raste dhe folja *jam* e ndjekur nga një paskajore. Në këtë rast folja *jam* merr kuptimin modal të domosdoshmërisë. P.sh.: nde krahanuertë tijnaj *ishte per tu veshunë* vete biri Tinezot C. P. II, I, 9; perse aty krishti *ishte per te lem* e aty kishte per te njoftune... C. I, III, 16; posi me thane veçë ne *jemi per të zanë* nji vend mbe tryeze... C. P. II, I, 14; tue marrë vesht se perse ish krijuem, se *ish per tu shumuem* shekulli, fort tue dashunë tha:... C. P. I, VI, 22.

Folja *jam* te Bogdani del edhe për të shprehur ndërtimet modale, e ngjashme për nga kuptimi me foljen modale *duhet*, në ato raste kur jepet një veprim që është i domosdoshëm në të ardhmen. P.sh.: Profetia ashtu anshtë thanë perse kallezonë punete qi janë për të ardhunë... C. P. I, I, 3; to te mira qi mortjet se tijnaj *ishinë per të ardhunë*, andyj tue mbetunë krishti... C. P. II, I, 3.

Krahas ndërtimeve me foljet *do, duhet*, ku këto folje dalin të përdorura si modale, te Bogdani gjejmë dhe ndërtime ku foljet *do, duhet*

e ruajnë mëvetësinë e tyre kuptimore leksikore. P.sh.: A di gia se zotynë *do me marrë* godin tand zot n'tejt? C. P. I, III, 6; Perse Selvia *doj e thanë e me kallezuem* Nierezin e Krishtit... C. P. I, II 10; Ma Mria kurraj nukë *desh me u perziem* tue gjetunë shumë mahanë C. P. I, II, 25; e foli me të vjehrrit tue i thanë se *i duhej me votunë* ndë Misijrt C. P. IV, 10.

Nuk mund të themi se folja *do* është plotësisht e desemantizuar pranë një paskajoreje. Këtë e tregon dhe përdorimi i saj me të njëjtën paskajore, d.m.th. në të njëjtin përdorim mund të dalë edhe si folje edhe si folje modale ose dhe pjesërisht modale. P.sh.: qi greqisht *do e thanë* pese e teukon *do me thanë* copa leterë C. P. I, I, 26; jo veçe qish *doj e thanë* anderra, po ende qish kish pa n'anderrë... C. P. I, II, 3. Alegorisht *doj* zotynë *me thanë*, se fjala, e ameshueshime kishte për tu veshunë nde misht te Nierit, nde krahanuerte se lumese Virgjinë C. P. I, III, 7.

Po këtë gjë e shohim edhe me foljen *mundete* si folje modale ose jo krejt modale. P.sh.: Pa e soditeni a *mundeni me njoftunë*, perse unë qi e leva mzisë po e njof. C. P. II, III, 1; a *mundeni me e gjetunë* një njeri qi bam kryq... C. P. I, I, 20; Mirë *mundetë me u thanë* se ndjerë shtansetë njoftin krijuesin e tyre C. P. II, I, 22; pra shpirti anshte i pa mort e *mundetë me pasë*, posi anshte thanë, o ndejese o pendese... C. P. I, I, 16.

Bogdani në vepër, gjatë përdorimit të foljeve modale sidomos me foljen modale *mund*, bën dallim në përdorimin e formave të saj. Kështu folja *mund* e ndjekur nga një *paskajore* del gjithmonë në formën e saj *mundetë*. Ndërsa, kur folja *mund* ndiqet nga mënyra lidhore, del në formë të reduktuar *munë*, ashtu siç e shohim të dalë edhe te Budi, por gjithmonë duke ruajtur të njëjtin funksion. Siç shihet në të folmet e Shqipërisë Verilindore dhe në Shqipërinë e Mesme ruhet kjo trajtë e reduktuar e foljes *mund*, biles në Shqipërinë e mesme kjo folje paraqitet në një trajtë edhe më të reduktuar, sidomos kur folja *mund* paraprihet nga pjesëza e mohimit *s'*. P.sh.: *s'un e baj*. Pas kësaj forme të shkurtër *munë* te vepra e Bogdanit gjejmë kurdoherë një lidhore pa pjesëzën *të* dhe asnjëherë një paskajore. P.sh.: si *munë jete* kjo punë, tha Virgjina perse burre nukë njof... J. Ch. I, II, 13; perse nukë *mune jene* teperië e pate ndegjuem tue munjtune veçe me thanë për tu njoftunë... C. P. I, III, 7.

Paskajorja te Bogdani paraqitet, siç e pamë edhe në shembujt e mësipërm, në dy forma: veprore e joveprore.

Forma joveprore e paskajores ndërtohet ashtu siç del në gegërishten e sotme me pjesëzën *u*, por ndonjëherë ndodh që paskajorja joveprore të ketë kuptim jovepror edhe pa qenë e shoqëruar nga kjo pjesëz, në këtë rast diateza përcaktohet nga vlera që merr folja në kontekst. P.sh.:

nukë duhete *me u marrë vesht*, se Hyji krijoj prashtu dhjete kore... C. P. I, IV, 18; duhete *me u pomendunë* ma para te levruemit e dheut... J. Ch. II, IV, 10; Na bijt e Shpirtit duhete *me u shumuem* posi hyjt e Qiellit. C. P. II, III, 3.

Te Bogdani paskajorja e trajtës joveprore del dhe me foljen ndihmëse *jam*. P.sh.: doj Jezu Krishti *me kjanë lyem*, vorruem... J. Ch. III, IV, 5; do jezu Prashtu si shkoj një dite, u lut *me kjanë gjegjunë* e të hinte Regji, t'sillt si kje perpara i tha... C. P. I, II, 6.

Megjithëse te forma foljore e pashtjelluar, veprimi i shprehur nga paskajorja lidhet me një kryefjalë pavarësisht se nuk ka tregues sintaksor, kjo kryefjalë mund të jetë ose e njëjtë me atë të foljes drejtuese ose e ndryshme.

E përdorur pas foljes modale *do, duhet*, paskajorja ka të njëjtën kryefjalë me foljen drejtuese. Kjo ndodh dhe me foljet aspektive si dhe me foljen *vote*. P.sh.: Për të veshtruemit e kësaj profetie, duhete *me dijtunë* se java nde te Shkruemit Shenjt. C. P. III, IX, 12; duhete *me u pomendunë* ma para te levruemit e dheut... J. Ch. II, IV, 10; Do Jezu Krishti *me kjanë lyem*, vorruem... J. Ch. III, IV, 5; pasi nde një shtator kah erdh *me mujtunë* shekullinë e Diallinë... C. P. III, III, 5; Andaj djali me gjithë forcë e fuqitë vet, po lufton *me mbajtunë* ngullë ndë mendtë dheut kete venë... C. P. I, VI, 16; *Vote* ndë Misirt' ndeper û te madhe *me lypunë* drithë... C. P. I, IV, 5; tue dijtunë gjithë sa po banhej *vote me i gjetunë*, e tue ecunë per mbij valetë Detit... J. Ch. II, IV, 11; fort dheu u tmerrue e vote me ju lutunë, atë dahej asi dheut... J. Ch. II, II, 16.

Shembujt me foljen *votë + paskajore* në shumicën e rasteve duhet të jenë ndikim i italishtes e jo një veçori e të folmes verilindore.

Paskajorja e varur nga foljet *urdhenej them*, del zakonisht me kryefjalë të ndryshme. Kjo ndodh edhe në disa raste të tjera, kur paskajorja shpreh raporte qëllimore, kushtore etj. P.sh.: Faqe nierit te naltë i dha, e qiellnë *me soditunë urdhenoj* C. P. I, VI, 4; *urdhenonte* ligja... te mos dil jashtë... as nde kishte *me votë* J. Ch. I, VI, 7; sa *thonë* filozofete se *me u ndalë* keta të sjellë te qielet, gjithë kish me mbetunë... C. P. I, IV, 38; i *tha* pa me thue nde qish lis me Suzanenë *me fejyem?* C. P. III, I, 8; ndonese *thoemi per te lem*, i pari vete anshte Ati... C. P. I, II, 14; i ndihmonte... *per te sherbyem d'Amenë*... J. Ch. I, VI, 13; se sillt rrodh gjak e ujë... *ujetë, per te delirunë* shpirtinatë tanë... C. P. II, II, 17.

Ndodh që kryefjala e paskajores të jetë kundrina e foljes drejtuese, p.sh.: Sauli, tue mos pam *gjindnë me kthyem* dergoj së dyjti trimatë me zanë e me ja shpum... C. P. III, II, 21; se djalli ndonese nxitem *nierinë*

me ndjekunë, vetë nukë anshtë nd'atë keqe... C. P. I, IV, 40; kush je ti qe po therret e nukë len *rejne me fjetunë*? C. P. II, III, 20.

Vendi i kryefjalës së paskajores nuk është i caktuar, ajo mund të vihet vetëm në fjalinë drejtuese (natyrisht, kur është e njëjtë për paskajoren dhe foljen drejtuese), ose vetëm para paskajores. P.sh.: Qendroj *Zoti* nde vend vet tekeqiat *me mos dashunë me e lanë* populline posi ju pat lutunë, C. P. II, I, 13; e posi thonë nukë rnoj *moti me mbyturnë* fëmijnë Izraelit... C. P. III, I, 22.

Raste kur kryefjala del para paskajores, p.sh.: *i silli për te vollen-duem* Rogjeneshenë te mallekueme kunatene vet, bani me i prem kryete... J. Ch. II, II, 7; Andaj *Zotynë për ta çuem*, i ngjalli tre anemiq te fortë C. P. II, IV, 12; *krijuesi per te kallezuem* te madhene dijene vet, u sherbye baltese dheut C. P. I, VI, 2; *i silli per ti ngushelluem* hipi nde barket... J. CVh. II, II, 16.

Te Bogdani ka dhe mjaft raste kur kryefjala e fjalisë kryesore rimerret, dhe në fjalinë me paskajore nga përremri lidhor. P.sh.: kje *Danieli i silli per te ikunë* mortnë lypi mot me u lutunë Tinezot qi ti kallezonte... C. P. III, IV, 3; se *Dielli* anshte një qen i lidhunë nder hekura, *i silli mundete me lehunë, e nxitunë*, me *me ngranë* aspak... C. P. I, VII, 5.

Këtyre u përgjigjen ndërtime të ngjashme edhe në tekstin latin ose italian sipas rastit. Kjo le të mendohet më tepër ndoshta për një ndikim të konstrukteve të këtyre gjuhëve, p.sh.: Era Daniele, quale per sfuggire la morte, domando tempo di pregare..., se *Demonio* e un Cane incaténato, *il quale* laterare potest, sollicitare potest...

Paskajorja te Bogdani vjen edhe pas foljeve që tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit, duke formuar me to togje të qëndrueshme. P.sh.: pas foljeve *zë, zë fill, mbaroj, vë, marr* etj.

Folja *zë* me një paskajore formon një tog ku folja *zë* tregon fillimin e veprimit dhe del më pak e përdorur në vepër se sa folja *zu fill*, e cila i jep togut të njëjtin kuptim. P.sh.: *zu me folë* për ditetë... J. Ch. II, VI, 20; Merimanga kanë *zu me tjerrë* kaqa hollë për të bam rjetne e vet me zanë miza... C. P. I, I, 4.

Zakonisht folja *zë* del në të kryerën e thjeshtë. Midis foljes *zu* dhe paskajores hyjnë dhe gjymtyrë të tjera të fjalisë. P.sh., mund të hyjë kryefjala që është e njëjtë për foljen *zu* dhe paskajoren, mund të hyjnë plotësa e rrethanorë të ndryshëm. Kjo tregon se këtu nuk kemi ngurosje të plotë të togut, por pjesët përbërëse mund ta ruajnë fare mirë mëvetësinë në fjali. P.sh.: Nde vonë *zun'* ende Perandoret e Romesë *me ndjekunë*... C.

P. I, I, 13; *zu Nazareti i Shkupsë fort me më perzanë*, ndë per ata vështeri te përzjarrshime... C. P. III, X, 3; *zun' ende me zgjedhunë e me shkruem* J. Ch. I, II, 19.

I ngjashëm me këtë tog del dhe ndërtimi me foljen *dhanë* + paskajoren dhe *hyj* + paskajoren, ku foljet *dhanë*, *hyj* marrin kuptimin e foljes *filloj*. P.sh.: e të tjerë *dhanë me folë* per Ndere... J. Ch. II, VI, 4; çuenë duerte, e sytë prej Qellshit, *hijnë me derdhunë* lot me denesene (incominciarono), J. Ch. IV, III, 2; atëhere Regjenijtë *hijnë me pervetunë*, ku ish aj Regj i ri? (cominciarono) J. Ch. I, VI, 3.

Në shumicën e rasteve folja *hyj* është në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore, në të tashmen, ose në të ardhmen e mënyrës dëftore të ndërtuar me foljen ndihmëse *kam* dhe paskajoren e foljes *hyj*. P.sh.: kur *him me u zbuluem* mbe kete shekullit tanë... C. P. I, V, 12; atehere *him me dijtunë* shekullinë e desheron me nxanë C. P. I, IV, 14; u përzie ende nde brez te Sethit per një qi *hijnë me u krushquem* me kainat, C. P. I, VII, 13; *ka me him me derdhunë* gjak... J. Ant. IV, IV, 16.

Edhe foljes *hyj* në kontekstin italisht i përgjigjet folja (cominciarono). Pra, përdorimi i foljes *hyj* me kuptimin e foljes *filloj* me sa duket do të jetë veçori e të folmeve të asaj krahine nga është Bogdani. P.sh.: çuene duerte, e sytë prej Qellshit *hijnë me derdhunë* lot me denesene, J. Ch. IV, III, 2; *hijnë me folë* keq tue ram ndë mend per vorbuj e mishit, C. P. III, I, 26; andaj *hini me kjam* fort te shuma lot J. Ch. III, I, 18.

Paskajorja që vjen pas foljes *hyj* mund të jetë si në trajtën veprorë ashtu edhe në trajtën joveprorë. P.sh.: *hini dheu me u mbushu në* e me u shumue, C. P. I, VII, 14; kur *hin me u zbeluem* mbë këtë shekullit tanë... C. P. I, V, 12; te parëletë *hinë me u anekuem* perse po paguhej ma te votet... J. Ch. II, V, 38.

Jo gjithmonë folja *hyj* del me kuptimin e foljes *filloj*. Ajo përdoret edhe me kuptimin e saj të mirëfilltë. P.sh.: shume re sillesh grishkeshinë *me hijm* mbrenda *me ngranë* me ta bashkë... J. Ch. III, I, 8; *hin* nder kaqa zoti Krisht *me pam* ato qi epinë... J. Ch. II, VI, 20; S. Pietri nder ka *hini me u nxem* tue pritunë me pam a po doj me u bam J. Ch. III, I, 8.

Lokucioni *zë fill*, në qoftë se mund ta ruajmë si të tillë, ka të njëjtin përdorim si folja *zë*, tregon fillimin e kryerjes së veprimit dhe me që te Bogdani nuk e hasim foljen *filloj*, me këto ndërtime, lokucioni *zë fill* shpreh fillimin e veprimit ashtu siç do ta paraqiste folja *filloj*. P.sh.: *zunë fill me ju bindunë* atij idhulli... C. P. I, I, 19; tue pam Filistejt të dalë

n'kreje ma të fortet tyne, gjithë *zunë fill me ikunë*, e Sauli tue i ndjekunë, shumë sish i mbyti, C. P. III, II, 8.

Folja *zë del* në të kryerën e thjeshtë, në më se të kryerën, në të tashmen pësore, në të tashmen e lidhores e në përcjellore. P.sh.: Aso diteje qi leu Krishti *zu fill me rjedhunë* voj mb'Romë,... J. Ch. I, IV, 18; i hojnë prapshtezë petekate, te sijat *kish zane fill me i veshunë* e i vunë... një tepek te kuq, J. Ch. III, II, 13; e madhe mrekuullij *zinhete fill me u bam* ... J. Ch. I, IV, 2; te sijtë kanë me ardhunë kur *te zanë fill Antikrishti me predikuem*, qi janë 1260... J. Ch. IV, IV, 8; tue *zanë fill bukurë me folë e me gjegjunë* J. Ch. II, IV, 20.

Midis foljes *zë fill* dhe paskajores hyjnë gjymtyrë të ndryshme, ashtu siç e pamë të hyjmë edhe te togu *zë + paskajore*. Disa fjalë hyjnë në mes të vetë togut *zë fill* dhe forcojnë kuptimin e fillimit të veprimit. P.sh.: *zu ende fill me u deftuem* shekullit, tue predikuem shemtinë Ungjijll J. Ch. I, VIII, 1; *zu fill* atë gurë lotesh *me lam* kambete J. Ch. II, III, 9; *zu fill* për te plotë *me kallëzuem* qish po vepronte Zotynë ndë tan' ... J. Ch. I, III, 6.

Paskajorja që vjen pas foljes *zë fill* mund të jetë në trajtën veprorë ose joveprorë. P.sh.: *zu fill me u deftuem* përkujdesshim... J. Ch. III, I, 2; *zu fill me u bam* Roma prej Rndit e Remulit... Lig. V; *zu ende fill me u deftuem* shekulli, J. Ch. I, VIII, 1.

Në të njëjtën mënyrë mund të trajtojmë edhe togun *vë + paskajore*. Ky tog tregon një vazhdimësi a një përpjekje për kryerjen e veprimit të shprehur nga paskajorja, por del më rrallë. Folja *vë* është në kohën e kryer të thjeshtë të dëftores si dhe në trajtën e përcjellores. Paskajorja që vjen pas saj, është zakonisht në trajtën veprorë. P.sh.: Ati i pushtueshim mbasi e pat me te dashunë pritune e *vu me ndenjunë* mb'ane diathtë, e tue soditunë plagete tijnaj... e peveti..., J. Ch. IV, II, 3; e *vune me ndenjunë* mbe një vend te naltë, J. Ch. III, II, 13; *tue vum* Danielnë *me ndenjunë*, thanë qi te shqyretojnë godinë... C. P. III, IX, 2; *vinhej* per urdhenë *për te hijm* nde uratë, e kujtime... J. Ch. I, II, 12.

Shpesh folja *bam*, si folje kauzative, lidhet me paskajoren dhe formon me të një kallëzues të përbërë, kjo folje shpreh fillim të përforcuar të veprimit që nuk realizohet, ndërsa paskajorja shpreh përmbajtjen leksikore të kallëzuesit. P.sh.: Adami ani bani *me dijtune* gjithë sej bijt e vet qi te qendrojnë nde Tinezot, C. P. I, VI, 21; per te sijet pune na *ban me dijtunë* Ozeza... C. P. II, I, 4; ashtu shterguem ndë shpella te poshtera te dheut *ban me dridhune* dheu, C. P. I, V, 30.

Folja *bam* mund të dalë në kohë e mënyra të ndryshme, si dhe në trajtën përcjellore ose paskajore. P.sh.: duel jashtë te mos piquej kund..., pasi ende *mebam me dijtunë* te Lumene Virgjine... J. Ch. III, I, 16; Prashtu *bane me shkruem* kete letere, e me u lutunë me gjithë zemere, J. Ch. II, I, 19; Prashtu shtini mort permbi kush t'ish aj, për të sillt pa baheshinë aqa te keqia e *te banhej me u mbytunë* C. P. III, XIV, 1; *kje* ende *bam me dijtune* prej Isajet se qet kishte me dekune. C. P. III, VI, 2; ka me lem krishti *tue kjanë bam me dijtunë* nde Naxaret... C. P. IV, XI, 1.

Ky kallëzues edhe në tekstin italisht del i ndërtuar po me foljen kauzative *bam*. P.sh.: kishte vum me dele, e per urdhenitë Samuelit e *bani me ardhunë* (facendolo venire) C. P. III, II, 1.

Folja *bam* edhe pas foljes gjysmëndihmëse si *do, duhete, mundete*, në trajtën e një paskajoreje shërben për të formuar një kallëzues të përbërë. P.sh.: sa ma fort *duhete me bam me u mrekulluem* shekulline ndete vumit roe... C. P. II, I, 4; *qish duhej me bam per te dobitunë* jete-në... J. Ch. II, V, 3; *mundete me bam me dijtunë* një mivete, J. Ch. III, III, 13.

Togu *bam* + *paskajore* shërben si kallëzues në fjali të ndryshme kundrinore rrethanore.

- në fjalinë kundrinore pas foljeve *do, urdhënoj, thom, le* etj. P.sh.: *do* se largu *me na bam me dijtunë*, C. P. II, II, 18; *desh* te mos vije puna nde vesh te regjit e te mos e *bam me vram*, iku C. P. III, I, 5; qi lypenë me u liruem Baraba, e Jezu Krishti *te banhej me u vram* J. Ch. III, II, 11; thane Zotit tinë *te banjë me reshunë* ziarre si n'Qellshit, J. Ch. II, V, 17.

- në fjali mënyrore. P.sh.: vinte perpara tyne, *tue i bam me dijtunë*, e tue i thanë, J. Ch. III, I, 5.

- në fjali krahasore. P.sh.: se une posi *banji me lem* te tjerë, ashtu ende lenj *bijnë* tem, C. P. I, III, 14.

- në fjali kushtore. P.sh.: *qish anshte* kjo punë qi thonë per ty se *ba me thirrë* regj. J, Ch. III, II, 2.

- në fjali qëllimore. P.sh.: votnë *me bam me dijtunë*.. J. Ch. IV, I, 8; *leftoj me bam me him* nde faj e mkat... C. P. I, VII, 1.

Përfundime

Te Bogdani trajtat e pjesores janë të formuara me prapashtesat përkatëse sipas temës së foljeve. Kështu dalin me prapashtesën *-unë* foljet me temë në bashkëtingëllore dhe disa folje me temë në zanore që

këtë prapashtesë e marrin për analogji. Kjo prapashtesë i shtohet zakonisht temës të së kryerës së thjeshtë.

Dalin me prapashtesën *-m* foljet me temë në zanore ose në dy zanore. Kurse prapashtesa *-në* dhe forma e saj e zgjeruar *-nunë* del zakonisht për të formuar pjesoret e foljeve me temë në zanore hundore. Foljet me temë në bashkëtingëllore, *l, ll, r, rr* e formojnë pjesoren me anë të prapashtesës *-ë*, por kjo s'është e vetmja formë pjesoreje, sepse një pjesë e mirë e këtyre foljeve e formojnë pjesoren dhe me prapashtesën *-unë*. Te vepra e Bogdanit pjesorja është përdorur gjerësisht për formimin e kohëve foljore, si dhe me vlerat e një mbiemri. Pjesoren te Bogdani e gjejmë si kallëzues emëror e si kallëzues te një fjali e varur. Ndërsa e përdorur si mbiemër pjesorja del herë e njëzuar e herë jo. Si e tillë pjesorja në fjali merr disa funksione sintaksore, si e afërt me ablativin absolut të latinishtes, si përcaktor kallëzuesor, si kallëzuesor të afërt për nga kuptimi me një ndajfolje etj.

Te Bogdani *paskajorja* del e shprehur me forma perifrastike, si: *me + pjesore* dhe *për të + pjesore*. Format *për me + pjesore* nuk dalin te Bogdani. Në vepër paskajorja ka një përdorim mjaft të përhapur, sepse përdoret në mjaft ndërtime gramatikore. Deri dhe format të së ardhmes, të kushtores te Bogdani dalin të shprehura me paskajoren. Te Bogdani kemi dy forma të paskajores, të asaj që mund ta quajmë të tashme në kundërvënie me format e kohës së shkuar të paskajores, si p.sh. *me pasë kjanë shkuem*. Paskajorja ka dy trajta: veprorë dhe joveprorë të formuara nga pjesëza përemërore *u* dhe folja ndihmëse *jam*. Në fjali paskajorja mund të përdoret si kallëzues i pavarur në fjali të pavarura, por mund të dalë dhe në shumë fjali të tjera të varura si kallëzues i varur. Si gjymtyrë e fjalisë paskajorja u përgjigjet mjaft funksioneve sintaksore, si: paskajorja kundrinore, rrethanore etj.

L'INFINITIF DANS L'OEUVRE DE BOGDANI

Summary

Dans cet expose, l'auteur se propose de donner un tableau aussi exact que possible des formes infinitivales qui risulnt du *Cuneus Prophaetarum*, un livre ecrit au XVII siecle par Pjetër Bogdani.

On voit parfaitement dans ce livre qui est une traduction en albanais, avec aussi des pieces proper de l'auteur, que Bogdani fait un louable effort a echapper aux formes dialectales de son lieu d'origine et a unifier les formes de la koine litterair de ces temps-la.

L'infinitif, chez Bogdani, par rapport aux autres aucteurs anciens, resulte, habituellement, muni de un participe, suivent des les particeles *për të, më*; avec des suffixes d'apres les themes des verbs, voire *-m*, pour les verbs que terminanten consonne; *-ne* pour les verbs que se terminant par une voyelle nasale et les verbes irregulier; *-e* pour les verbs se terminant un consonne liquide. L'infinitif de cet teme peut resulte, dans quelque cas, aussi con participles se terminant par le suffix *unë*.

Bogdani reconnait comme l'infinitif dans son œuvre aussi l'infinitif passé passif. La forme compose *për të, me kjanë bam*, a la difference des autres auteurs est usitée par Bogdani.

L'infinitif peut faire dans la phrase, des fonctions differentes comme determinant.

Bibliografia

Bopp, Fr. *Über das Albanesische in seinen vereandschaftlichen Beziehungen.*

Cimohowski, W. Die Albanischen presentbildungem auf -io und -nio.

Demiraj, Sh. (1970). *De la disparation de l'infinitif en albanais.* Etudes Balkaniques.

Demiraj, Sh. *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa II), 1976.

Dialektologjia shqiptare I, II, III.

Domi, M. *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (konspekt leksionesh), 1961.

Gabinskij, A. M. (1970). *Pojavlenie i utrata pervicnogo albanskogo infinitiva.* "Nauka" Leningrad.

Hahn, G. *Albanesische Studien*, II, 87.

Hoxha, Sh. (1975). *Vëzhgime mbi të folmen e Vile Kalisit të Lumës – D. Shq. III.*

Lafe, E. *Trajtat e pjesores te Gjon Buzuku*, Në Konf. I. Alb., 1965.

Mansaku. S. (1982). *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj.* S. F. 1982/1.

Mulaku, L. *Govor Albanaca Bajgorske Salje*, 1968.

Totoni, M. *Përcaktori kallëzuesor*, "Studime filologjike", 1976, 3.

Weigand, G. *Albanesische Grammatik im Sudgegischen Dialekt* 34.

Xhuvani, A. *L'infinitif en Albanais*, "Lingua Posaniensis" VIII, 1960.

Xhuvani, A. *Pjesorja në shqipe*, në "Studime gjuhësore" Tiranë, 1956.

Bibliografía

Bopp, F. Über das Albanische. In: *Journal asiatique*, 1815, t. 1, p. 1-10.

Campbell, W. Die Albanische Grammatik. Leipzig, 1853.

Dennis, Sir Henry. The Albanians. London, 1855.

Dimitroff, S. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.

Domi, M. Morphologie der albanischen Sprache. Leipzig, 1880.

Erasmussen, J. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.

Falk, G. Albanische Studien. Leipzig, 1880.

Horn, S. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.

Ilak, J. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.

Jakobson, R. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.

Klein, J. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.

Müller, J. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.

Reich, M. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.

Weigand, G. Albanische Grammatik im jugoslavischen Gebiet. Leipzig, 1880.

Xhuvani, A. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.

Xhuvani, A. Die Albanische Sprache. Leipzig, 1880.